



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 730/11 Prot.

Tiranë, më 26/12/2016

V E N D I M

Nr. 163, Datë 26/12/ 2016

**PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË LIBRAZHD DHE 6-
ISH-KOMUNAT, STEBLEVË, POLIS, ORENJË, LUNIK, HOTOLISHT,
QENDËR LIBRAZHD “MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE
RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të auditimit të mësipërm, Drejtori i Përgjithshëm në mbështetje të nenit 10,15 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, vlerësimit financiar dhe menaxhimit të administrimit të aseteve të qëndrueshme”, të ushtruar në Bashkinë Librazhd dhe 6 ish-Komunat Steblevë, Polis, Orenjë, Lunik, Hotolisht dhe Qendër Librazhd, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 30.6.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Bashkia Librazhd nuk ka ngritur dhe miratuar një sistem të përshtatshëm dhe efektiv të **menaxhimit financiar dhe të kontrollit** në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për periudhën objekt auditimi, si më poshtë,

-nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe nuk janë realizuar takime në lidhje me mangësitë që shqetësojnë njësinë në lidhje me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

-nuk ka një kuptim të qartë të menaxhimit të riskut, nuk ka strategji të riskut apo identifikim të tij sipas nenit 21 të ligjit.

-nuk është formuluar deklarata e vizionit dhe misionit të njësisë në të cilën përcaktohen objektivat strategjike afatgjatë për Bashkinë Librazhd në zbatim të kërkesave të VKM-së nr.691,

datë 29.7.2015 "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020".

1.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik (GMS), të formulojë deklaratën e vizionit dhe misionit të njësisë, të hartojë regjistrin e riskut në mënyrë që të identifikohen, vlerësohen dhe kontrollohen ngjarje të mundshme që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të insitucionit.

Brenda muajit Mars 2017

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Librazhd, bazuar në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik kishte krijuar strukturë auditimi të brendshëm edhe pse ka pasur vetëm një ndërmarrje në vartësi. Auditimin e aktivitetit financiar të Bashkisë Librazhd dhe ish-Komunave e ka kryer njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Librazhd, njësia e Auditit të Brendshëm të Prefekturës Elbasan dhe KLSH.

2.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa që organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm të bëhet në përputhje me ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 "Për auditim e brendshëm publik" neni 10 "Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm" dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin Publik".

Brenda muajit Mars 2017

3. Gjetje nga Auditimi: Në auditimin e aktivitetit të njësive vartëse Klubit të Futbollit "Sopot", rezultoi se aktiviteti ekonomik-financiar i viteve 2013 e 2014, është audituar nga auditimi i brendshëm i Bashkisë dhe në përfundim të auditimit ka rezultuar se:

Janë konstatuar shkelje të dispozitave ligjore, duke mos u dokumentuar veprimet ekonomike, si tërheqjet me çek nga banka, nuk janë kontabilizuar likuidimet e kryera nëpërmes degës së thesarit, por vetëm është mjaftuar duke u mbështetur në të dhënat e nxjerra nga Dega e thesarit Librazhd (rakordim i njëanshëm), nuk janë dokumentuar hyrjet në magazinë për periudhën e audituar, si dhe mangësi të tjera.

Nga auditimi rezultuan shkelje **me dëm ekonomik** në vlerën **883,200 lekë** të detajuara si më poshtë:

a. pagesa në vlerën **792,600 lekë**, për udhëtim e dieta brenda vendit të 44 personave sipas listës bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010 "Për udhëtim e dieta brenda vendit",

b. blerje karburanti në vlerën **90,600 lekë**, nga ish nëpunësi autorizues B K, kërkuar shpërblim dëmi sipas urdhrat të kryetarit të Bashkisë nr.271, datë 18.11.2015.

3.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për analizimin e Raportit Final të auditimit të ushtruar nga njësia e auditimit të brendshëm të Bashkisë Librazhd, në Klubin e Futbollit Sopot, për arkëtimin e detyrimit për **vlerën 883,200 lekë** nga përfituesit (sipas listës nxjerrë nga Sektori i Auditit Brendshëm të Bashkisë Librazhd) dhe të nxirret përgjegjësia për moszbatimin e rekomandimeve.

Brenda muajit Mars 2017

4. Gjetje nga auditimi. Për vitin 2015, janë trashëguar nga komunat mangësi të theksuara në mbylljen e bilanceve të 6/mujorit parë të vitit 2015. Inventari kontabël është i pa mbështetur me analizë të llogarive inventariale të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në shumën **366,491,419 lekë**, që i përket ish-Komunave Hotolisht e Polis, sipas tabelës bashkëlidhur, në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik.

Në mënyrë tabelore mos rakordimet paraqiten si më poshtë:

Nr	Ish- Komunat	Sipas llogarive (në lekë)			Total sipas komunave
		212	213	214	

1	Hotolisht	98,480,486	165,721,283	615,000	264,816,769
2	Polis	33,828,707	67,295,915	550,028	101,674,650
3	Totali	132,309,193	233,017,198	1,165,028	366,491,419

4.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për inventarizimin e aktiveve (ndërtesa, rrugë dhe objekteve të tjera), në vlerën 366,491,419 lekë në Njësitë Administrative Hotolisht e Polis dhe të shoqërojnë me analizat përkatëse llogaritë 212- Ndërtesa dhe konstruksione, 213 - Rrugë, rrjete, vepra ujore, 214 -Instalime teknike.

Brenda muajit Maj 2017

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i bilancit të muajit Qershor 2015 të ish-Komunës Hotolisht, rezulton se është kontabilizuar vlera **6,883,963 lekë**, për 10 kontrata dhe fatura të mbartura nga viti 2012, nuk është kontabilizuar vlera **944,700 lekë** e një kontrate, pa datë, me operatorin ekonomik Z, nuk është lënë asnjë gjurmë e procedure prokurimi për lidhjen e 10 kontratave.

5.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd, të mos likujdojë detyrimin për 10 kontratat e mbartura nga viti 2012, të ish-Komunës Hotolisht, në vlerën 7,828,663 lekë, pa vendim gjykate të formës së prerë për njohjen e detyrimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetjet nga auditimi: Mbas reformës vendore në Bashkinë Librazhd, në lidhje me ndihmën ekonomike u konstatua se ka pasur mungesë të personelit të sektorit të ndihmës ekonomike, duke vështirësuar administrimin, kontrollin, dokumentimin e gjendjes social-ekonomike të familjeve që trajtohen me NE e PAK, me efekte të risqeve të shtuara operacionale, nuk ishin publikuar në listat emërore të përfituesve të ndihmës ekonomike, nuk janë depozituar listëpagesat e ndihmës ekonomike mujore,firmosur nga përfituesit e ndihmës ekonomike, në dosjen e Administratorit të Ndihmës Ekonomike, në kundërshtim me ligjin nr.139/2015”Për vetëqeverisjen vendore” dhe Udhëzimin e ish-MPÇSSHB nr. 338/3, datë 10.03.2006 “Mbi zbatimin e VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”.

6.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për plotësimin e organikës së këtij sektori me specialist të fushës, në mënyrë që ky sektor të kryejë detyrat e administrimit të fondit të ndihmës ekonomike si në Bashki dhe 6 Njësitë Administrative. Në vazhdimësi të hartohen raporte të monitorimit të vijueshmërisë së pagesave të përfituesve të ndihmës ekonomike.

Menjëherë

7.Gjetje nga auditimi: Për vitet 2015, 2016 për shpërndarjen e ndihmës ekonomike nuk është hartuar kontratë nga Bashkia Librazhd me Postën Shqiptare, Dega Librazhd, në kundërshtim me VKM nr.1237, datë 16.12.2009 “Për një shtesë në VKM nr.787, date 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar.

7.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të hartojë kontratë vjetore për shpërndarjen e fondit të ndihmës ekonomike me degën e ■ sha Librazhd.

Menjëherë

8.Gjetje nga Auditimi: Nga krahasimi i listë pagesave për numrin e nëpunësve të paguar me strukturën sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak (numër total), nuk u konstatuan pagesa mbi organikën e miratuar çdo fillim viti buxhetor. Për vitin 2016, në projektin e paraqitur nga bashkia për strukturën është përcaktuar numri 403 punonjës, pa kryer një studim paraprak me grup të veçantë pune, për numrin e domosdoshëm të nëpunësve, pa detajuar sipas sektorëve dhe drejtorive. Nuk është plotësuar organika me 33 veta për vitin 2016, duke rezultuar mos shpenzim për paga dhe sigurime shoqërore, konkretisht nga 27,931mijë lekë të planifikuara për paga janë realizuar 22,554 mijë lekë ose 80.7%, shpenzimet për sigurime shoqërore nga 4,141 mijë të planifikuara janë realizuar 3,563 mijë lekë ose 86%. Në këto kushte Bashkia Librazhd duhej të rishikonte buxhetin e 6/mujorit 2016 sipas kërkesave të nenit 47, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë“.

8.1. Rekomandim: Nga Bashkia të merren masa për rishikimin e organikës me një grup pune të veçantë dhe të bëhen ndryshimet në buxhet për fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore për vitin buxhetor 2016.

Në vijimësi

9.Gjetje nga Auditimi: Për periudhën e audituar, në lidhje me rekrutimin e personelit të Bashkisë Librazhd u konstatua se:

- pas reformës administrative janë marrë në punë 13 nëpunës, pa u zhvilluar procedurat e konkurrimit,
- nga 89 nëpunës të bashkisë,kanë përfituar statusin e nëpunësit civil 9 (nëntë) nëpunës, në kundërshtim me ligjin nr. 152/ 2013 “Për nëpunësin civil”, nenet 22,23 e 24,
- 80 nëpunës të Bashkisë nuk kanë kontrata pune, në kundërshtim me nenet 12 dhe 20 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995” Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë“,
- nuk është përditësuar regjistri themeltar i punonjësve, për lëvizjet e nëpunësve që i përkasin periudhës viti 2015 dhe 6/mujori i vitit 2016 ,
- dosjet e personelit nuk janë të plotësuar me elementët e nevojshëm sipas kërkesave të Aneksit I dhe II-të , të VKM nr. 117 datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe Administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit.

9.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për realizimin e procedurave të pranimit në punë konform kërkesave të përcaktuara në statusin e nëpunësit civil dhe për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, të lidhen kontratat përkatëse. Nga Përgjegjësi i Sektorit të Arkivit dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë Librazhd të merren masa të përditësohet regjistri themeltar i nëpunësve dhe të plotësohen dosjet e personelit me inventarët përkatës.

Menjëherë

10. Gjetje nga Auditimi:Në ish-Komunën Lunik dhe ish-Komunën Orenjë janë kryer shpenzime **2,989,200 lekë**, për punonjës sezonal për mirëmbajtjen e rrugëve rurale nëpërmes artikullit nr.602, shpenzime operative, pa i deklaruar ato në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, duke iu shmangur detyrimeve të pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, në kundërshtim me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar me ligjin nr.10070, datë 5.2.2009, neni13 pika 2 “Detyrimi për të paguar kontributet”, nenin 79 “Detyrimet e punëdhënësit dhe të vetë punësuarit”, i ndryshuar me ligjin nr.104/2014, datë 31.07.2014, neni 10, duke shkaktuar **të ardhura të munguara në shumën 833,986 lekë**.

10.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa që punonjësit të trajtohen sipas klasifikimit të rregullit buxhetor (artikulli 600, 601), dhe të mos trajtohen si shpenzime operative.

Brenda muajit Maj 2017

11. Gjetje nga auditimi: Nga ana e Zyrës Taksave nuk është ndarë detyra për secilin punonjës, edhe pse nga ish-komunat është dorëzuar detyra me procesverbal, por ndërkohë nuk është kryer një inventar fizik i dosjeve të vetë Bashkisë Librazhd, me qëllim që të evidentohet dokumentacioni që mungonte, si deklaratat e qarkullimit të xhiros, njoftim-vlerësimet e detyrimeve tatimore, fotokopje e dokumentit të pagesës së taksave, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015”Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

11.1.Rekomandimi: Zyra e taksave e Bashkisë Librazhd të marrë masa për ndarjen e detyrave për secilin punonjës të zyrës tatimeve, duke u caktuar numrin e bizneseve sipas NUIS (Nipteve) apo fshatrave për taksën e tokës dhe taksat e popullatës.

Dosjet e subjekteve tatimpaguese të inventarizohen dhe plotësohen me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 29, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH.” i ndryshuar respektivisht: me Fletën e Inventarin dhe përmbajtjen e Dosjes, deklaratat

parashikuese të qarkullimit vjetor; njoftim vlerësimi tatimor; dokumenti i pagesës së detyrimit, gent-planet apo planimetritë për taksën e ndërtesave, akt-konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, të konfirmuara dhe nga Policia bashkiake etj.

Menjëherë

12.Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Librazhd (Zyra e taksave) nuk është krijuar një regjistër i veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qira, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës, me të dhënat si vijon:

a. Emërtimi i pronës, NIPTI dhe vendndodhja (shoqëri koncesionare, objekti i dhënë me qira, shoqëri tregtare);

b. Për kontratat e koncesionit dhe enfiteozës - Objekti i koncesionit, afati në vite, kushti bazë i pagesës, fillimi i pagesës, arketuar deri në vitin, viti aktual (planifikuar, derdhur), parashikimi për vitin e ardhshëm, etj.

Në kundërshtim me pikën 31, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

12.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd (Zyra e taksave) të marrë masa për hapjen e një regjistri të veçantë për secilën nga pronat e dhëna me qera, shoqëritë tregtare në të cilat shteti zotëron aksione dhe kontratat e koncesionit dhe enfiteozës, me të dhënat e përcaktuar në pikën 31 shkronjat (a,b,c,) të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Të dhënat e kontratave të qerasë me të gjitha elementët dhe sipas viteve të informatizohen në mënyrë elektronike duke i ndjekur në vazhdimësi arkëtimin e tyre.

Brenda muajit Mars 2017

13.Gjetje nga Auditimi: U konstatua se Bashkia Librazhd në strukturën e re organizative të vitit 2015, nuk ka krijuar zyrë të veçantë për administrimin e tokës brenda territorit të saj, por ka caktuar një specialist pranë Drejtorisë së kontrollit të territorit dhe zhvillimit urban, në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” dhe VKM nr.121, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”.

13.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa për ngritjen e ZMMT (Zyrës së Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës), për administrimin dhe ruajtjen dokumentacionit të fondit të tokës të ish-Komunave, me specialistë të fushës.

Brenda muajit Mars 2017

14.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për administrimin e tokave bujqësore në ish-Komunat Qendër Librazhd, Stëblevë, Orenjë, Hotolisht dhe Polis, për vitet 2013, 2014, 2015, u konstatua se 827 familje nuk janë pajisur me AMTP (Akte të marrjes së tokës në pronësi), nuk janë krijuar dosje për secilin përdorues të tokës, nuk ka evidenca të klasifikimit të tokave bujqësore, nuk ka proces verbale për transferimin e zërave kadastral tokë bujqësore në troje, nuk disponohen regjistra të tokës bujqësore, miratuar me urdhrin e përbashkët, nr.107, datë 27.3.2009 të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Brendshëm nuk janë dërguar informacione mbi dëmtimet e tokave, pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes Tokave (DAMT) të Këshillit të Qarkut Elbasan, në kundërshtim me pikën 1/1, neni 17 i ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, VKM nr.253, datë 6.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore”, nenet 6, 9 dhe 12, të ligjit 8752 datë 26.3.2001 “Për krijimin edhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës” i ndryshuar si dhe VKM nr.121 datë 17.2.2011, kreu IV “Detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të zyrave të menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës (ZMMT) në komuna dhe/ose bashki”, kreu IV, pika 2, gërma “f”.

14.1.Rekomandim:Bashkia Librazhd të ngrejë komisione me specialistë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës së Qarkut Elbasan (DAMT), për përditësimin e sipërfaqeve të tokës, pajisjen me AMTP të 827 familjeve, në Njësitë Administrative Qendër Librazhd, Polis, Hotolisht dhe regjistrimin e tyre pranë ZVRPP Librazhd, sipas kërkesave të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për regjistrimin e Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi” si dhe të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm mbi transferimin e zërave kadastral, dëmtimin e tokave, klasifikimin dhe kategorizimin e tokave dhe plotësimin e regjistrave të tokave.

Brenda vitit 2017

15.Gjetje nga Auditimi: U konstatua se nga DSHP Librazhd është transferuar sipërfaqja 15106 hektarë pyje dhe 9675 hektarë kullota pranë ish-Komunave Qendër Librazhd, Stëblevë, Lunik, Polis, Hotolisht, Orenjë, nga të cilat vetëm ish-Komuna Qendër Librazhd ka regjistruar 41 ha pyje pranë ZVRPP Librazhd, ku rezultoi se:

- nuk është bërë inventarizimit fizik i sipërfaqeve,
- nuk është bërë identifikimi i pasurive në terren,
- nuk janë përgatitur hartat përkatëse,
- mungon rakordimi me ZVRPP për gjendjen juridike të pasurive, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”i ndryshuar.

15.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, nëpërmjet Drejtorisë së administrimit dhe mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave, të marrë masa për inventarizimit fizik, identifikimin e pasurive, plotësimin e hartave dhe rakordim me ZVRPP për sipërfaqet pyjore dhe kullosore në pronësi të saj, sipas kërkesave të VKM nr. 433, datë 08.6.2016”Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish- komunave/ bashkive”.

Brenda muajit Maj 2017

16. Gjetje nga auditimi: Për menaxhimin e pasurive pyje e kullota, nga ish-Komunat Qendër Librazhd, Stëblevë, Lunik, Polis, Hotolisht, Orenjë, janë përpiluar dhe miratuar plane të ndryshme për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave, sipas kërkesave të nenit 5, pika 5 të ligjit nr. 9585, datë 04.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar. Nuk ka evidenca për bashkëpunimin me Ministrinë e Mjedisit dhe shoqatat e pyjeve dhe atyre mjedisore, në kundërshtim me kërkesat e pikës 5/dh të VKM nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”.

16.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Pyjor Elbasan, të ngrejë grupe pune me specialistë për unifikimin e planit të mbarështimit dhe ruajtjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, në gjithë njësitë administrative të saj.

Brenda muajit Maj 2017

17.Gjetje nga auditimi: U konstatua se nuk ka dokumentacion mbi përdorimin e kullotave nga komuniteti (fshatrat), në kundërshtim me VKM nr.632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve për kullotje dhe kositje” dhe ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”.

17.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd, të marrë masat organizative për evidentimin, regjistrimin dhe lidhjen e kontratave për përdoruesit e sipërfaqes kullosore në njësitë administrative sipas pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit Mjedisit dhe Pyjeve nr. 4 datë 10.4.2008 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave e livadheve dhe procedurat për dhënien për kullotje e kositje bari”, për të krijuar të ardhura për Bashkinë.

Brenda muajit Maj 2017

18.Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i organizimit të policisë bashkiake, strukturë me dy inspektorë për periudhën deri në vitin 2016, u konstatua se:

-nuk janë plotësuar libra shërbimi për dokumentimin e daljes në shërbim të policisë sipas urdhrave të titullarit,

-nuk janë të dokumentuar rastet e urdhrave verbal dhe regjistrimi i përfundimit të shërbimit,

-nuk janë mbajtur procesverbale apo dokumentuar kontrolle në terren për mbjellje të bimëve narkotike,

-nuk janë organizuar plane veprimi me kryepelqtë e fshatrave, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të ish-Komunës”, i ndryshuar,

-nuk janë lidhur kontrata pune për një periudhë jo më pak se tre vjeçare me punonjësit e policisë bashkiake në kundërshtim me urdhrin e përbashkët të “TIP” nr.1, datë 17.4.2003 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Pushtetit Lokal “Për miratimin e rregullores së brendshme”TIP” të policisë bashkiake”, neni 11, pika 7,

Konstatohet se është emëruar sipas urdhrit të kryetarit të bashkisë nr.68, datë 12.02.2016, në detyrën e policit të bashkisë P.ZH. marrë në punë në kundërshtim me nenin 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të ish-Komunës”.

18.1.Rekomandim: Nga Përgjegjësi i Sektorit të Arkivit dhe Burimeve Njerëzore të Bashkisë të lidhen kontratë pune me punonjësit e policisë bashkiake që janë në marrëdhënie pune dhe rekrutimi i policëve në punë të kryhet me komision të posaçëm, sipas kërkesave ligjore. Të vendoset libri i shërbimit për aktivitetin e Policisë Bashkiake

Brenda muajit Mars 2017

19. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Librazhd, u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e pakësimit të sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor, për 1118 Ha nga 18 subjektet që janë pajisur me Leje Minerare nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, për pasojë janë krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Librazhd në **vlerën 492,074,400 lekë**, siç përcaktohet në nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, pikat 3, 7, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor”.

19.1. Rekomandimi: Bashkia Librazhd, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit, që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjorë dhe kullosor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohej Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe kryerjen e pagesës së detyrimeve nga dëmtimi i fondit pyjor/kullosor.

Brenda muajit Shkurt 2017

20.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në **ish-Komunën Qendër Librazhd**, dërguar me shkresën nr. 308/8, datë 30.5.2014, dhe të rikërkua për zbatim me shkresën nr. 308/10, datë 20.10.2014, u konstatua se:

a. nga 9 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa, nuk janë zbatuar 4 masa të pasqyruara në bilancin kontabël,

b. nga 13 masa për shpërblim dëmi, për 55 subjekte dhe persona në vlerën **2,864,395 lekë**, janë arkëtuar detyrimet për dy masa në vlerën 645,813 lekë. Janë në proces arkëtim nga **53 subjekte vlera 2,218,654 lekë**.

20.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të pa realizuara të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, dhe të arkëtojë nga 53 personat dhe subjektet përgjegjës vlera **20,056,049 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

21.Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria e Planifikimit Urban, rezulton se për periudhën 2 vjeçare 2013-2014 janë dhënë 15 leje shfrytëzimi dhe leje zhvillimi të cilat një pjesë kanë filluar dhe një pjesë kanë përfunduar punimet apo janë në proces, ndërkohë nuk kanë dorëzuar në IMTV, dosjen e plotë me dokumentacionin e nevojshëm. Duke mos zbatuar UKM nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I-Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se: 11. Sipërmarrësi, jo më pak se 10 ditë përpara fillimit të punimeve, njofton me shkrim seksionin e urbanistikës, që ka lëshuar lejen, dhe degën rajonale të Policisë së Ndërtimit. Në njoftim jepen të dhëna për objektin, investitorin/sipërmarrësin, subjektin projektues e mbikëqyrës, dokumentacionin administrativo-ligjor të miratuar dhe për personelin drejtues të kantierit të punimeve.

21.1.Rekomandimi: Nga ana e Inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore, duhet të hapë dosje për secilin subjekt ndërtues si privat dhe me fonde shtetërore dhe të dorëzohen në zyrën e arkivit Bashkia Librazhd, se bashku edhe me dokumentacionin e ish-Komunave, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.

Brenda muajit Mars 2017

22.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Librazhd, për periudhën 2013, 2014, 2015 dhe 2016, u audituan 4 kontrata zbatimi punimesh të cilat ishin përfunduar, ishin kolauduar dhe ishin marrë në dorëzim, ku rezultuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në UKM nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

22.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Brenda muajit Mars 2017

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Në mbështetje të shkronjës (a) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të neneve 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë audituar, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për kompensimin dhe shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 38.778.004 lekë, si më poshtë:**

1.Gjetje nga Auditimi: Nga verifikimi i inventarëve fizik të vitit 2015 të shkollave në administrim të ish- komunave dhe Bashkisë Librazhd u konstatua se:

- nuk është rakorduar me Zyrën Arsimore Librazhd, për furnizimet me mallra dhe materiale të shkollave për vitet 2013, 2014, 2015,
- u konstatuan në 15 raste, materiale të papërfshira në inventarin e disa shkollave si kompjuterë, projektor, laptop etj me vlerë **1,702,944 lekë**, me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH, nga vetë Bashkia Librazhd, u hartua akt rakordimi i datës 04.10.2016 midis Bashkisë me Zyrën

Arsimore Librazhd, në kundërshtim me pikat, 51, 56, 81, 82 e 83 e Udhëzimit të Ministrisë Financave nr.30, datë 27.11.2011”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nenit 5 të ligjit nr. 10296 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neneve 6 e 11,të ligjit nr. 9228 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

1.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,702,944 lekë**, nga 16 persona, sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Janar 2017

2.Gjetje nga auditimi:Në 4 ish-Komunat rezultoi se janë kryer shpenzime telefonie celulare respektivisht:

-**30,000 lekë dëm ekonomik**, ish Kryetari i Komunës Polis

-**300,000 lekë dëm ekonomik**, ish-Kryetari i Komunës Lunik

-**196,000 lekë dëm ekonomik** ish-Kryetari i Komunës Stëblevë

Pagesat e mësipëme janë në kundërshtim me VKM nr.864, datë 23.07.2010 “Për pajisje me numër telefoni celular”, pika 9 dhe 11, ku përcaktohet si kufi përfitimi për këtë natyrë shpenzimi, niveli i pagës së pozicionit “Drejtör i Përgjithshëm në Ministri”.

2.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të nxjerrë aktin administrativ për ndalesën, të kontabilizojë dëmin ekonomik në shumën **526,000 lekë** dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e shumave respektivisht nga; z.**V.T.** ish-Kryetari i Komunës Polis në vlerën 30,000 lekë, z.**A.Xh.** ish-Kryetari i Komunës Lunik në vlerën 300,000 lekë dhe z. **A.F.** ish-Kryetari i Komunës Steblevë në vlerën 196,000 lekë.

Brenda muajit Janar 2017

3.Gjetje nga Auditimi: U konstatua se në Bashkinë Librazhd dhe ish-komunat janë kryer pagesa për këshilltarët, pa marrë pjesë në mbledhjet mujore, pa hartuar listë prezenca të rregullta, nga ballafaqimi i listë pagesave me protokollin e mbledhjeve të këshillave, në vlerën totale **8,552,208 lekë dëm ekonomik**, të ndara si vijon:

-Bashkia Librazhd në vlerën **1,216,218 lekë** për 31 këshilltarë,

-ish- Komuna Lunik në vlerën **245,025 lekë** për 12 këshilltarë,

-ish- Komuna Orenjë në vlerën **940,913 lekë** për 15 këshilltarë,

-ish-Komuna Polis në vlerën **571,658 lekë** për 22 këshilltarë,

-ish-Komuna Qendër Librazhd në vlerën **2,508,854 lekë** për 30 këshilltarë,

-ish- Komuna Hotolisht në vlerën **1,704,690 lekë** për 23 këshilltarë,

-ish-Komuna Stëblevë në vlerën **1,364,850 lekë** për 19 këshilltarë,

Pagesa këto në kundërshtim me ligjin nr. 8652,datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2; neni 31, pika 2 dhe pika 8.

3.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 152 persona të shumës prej **8,552,208 lekë**, sipas anekseve nr. 2,6,7,9,10,11,12 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajit Mars 2017

4.Gjetje nga Auditimi: Me urdhër pagesën nr.282, datë 19.12.2014, të ish-Komunës Lunik, është aplikuar shpërblim në masën 10,000 lekë për 7 nëpunës, në shumën gjithsej **63,000 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me VKM nr. 905, datë 17.12.2014 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të KM, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

4.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 63,000 lekë, nga 7(shtatë) nëpunësit e ish-Komunës Lunik, për sa kanë përfituar padrejtësisht shpërblim për vitin 2014.

Brenda muajit Mars 2017

5.Gjetje nga Auditimi: Sipas Urdhër shpenzimit nr. 255, datë 30.12.2014, për **vlerën 115,200 lekë dëm ekonomik**, është aplikuar shpërblim për 16 nëpunës të ish-Komunës Orenjë për vitin 2014, në masën 8,000 lekë/nëpunës, në kundërshtim me VKM nr. 905, datë 17.12.2014 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010, të KM, “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

5.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **115,200 lekë** për sa kanë përfituar shpërblime 16 nëpunës, të ish-Komunës Orenjë.

Brenda muajit Maj 2017

6.Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Steblevë, me urdhër shpenzimin nr. 182 datë 23.12.2013, në vlerën **30,000 lekë dëm ekonomik**, për periudhën Nëntor- Dhjetor 2013 i janë paguar bonus ish-Kryetarit të Komunës Steblevë z. **A.F.** në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.169/2013, datë 07.11.2013 “Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit për disa funksionar publik”.

6.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **30,000 lekë** nga Alban Fejza, sa përfituar padrejtësisht bonus transporti.

Menjëherë

7.Gjetje nga Auditimi: U konstatua se:

- në ish-Komunën Lunik, aplikuar gabim tatimit mbi të ardhurat në dy raste, **në vlerën 6700 lekë dëm ekonomik**, sa më poshtë:

-vlëra 4,000 lekë në favor të Xh.G. nga aplikimi gabim i tatimit mbi të ardhurat(10%), shpenzim për pagë mbështetur në kontratën e datës 03.01.2014, me afat 3 muaj, në vlerën 72,000 lekë, me urdhër shpenzimin nr.88, datë 07.05.2014;

-vlëra 2,700 lekë në favor të V.M. dhe H.Sh. nga aplikimi gabim i tatimit mbi pagë (10%), pagesë transporti sipas mandat pagesës së arkës nr.6, datë 28.03.2014, në vlerën 18,000 lekë,

-në ish-Komunën Hotolisht, aplikuar gabim tatimit mbi të ardhurat në tre raste, **në vlerën 285,165 lekë dëm ekonomik**, sa më poshtë:

- Xh.S. (objekt me qira), për vlerën 13,680 lekë,

- 10 punonjës të administratës, për vlerën 126,000 lekë,

- 22 ish-këshilltarë të Komunës, për vlerën 145,485 lekë në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 9, pika 2.

7.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masa dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin e vlerës **291,865 lekë**, respektivisht nga: Xh.G. 4,000 lekë, V.M. 2400 lekë, H.Sh. 300 lekë, Xh.S. 13,680 lekë, 10 punonjës të administratës së ish-Komunës Hotolisht 126,000 lekë, 22 ish-këshilltarët 145,485 lekë.

Brenda muajit Maj 2017

8. Gjetje nga auditimi: U konstatuan pagesa pa aplikuar tatimin në burim, për mbikëqyrësin e punimeve të ndërtimit Gj.P. në dy objekte të ish-Komunës Orenjë, **në vlerën 285,165 lekë dëm ekonomik**, si më poshtë:

- **103,105 lekë**, nga llogaritja tepër e shërbimit të mbikëqyrjes së zbatimit të projektit të shkollës 12-vjeçare Orenjë, sipas urdhër shpenzimit nr. 149. datë 11.08.2014 për vlerën 240,000 lekë,

- **32,823 lekë**, nga llogaritja tepër e shërbimit të mbikëqyrjes së zbatimit të projektit “Ndërtim Ure tip bejl për fshatrat Gurakuq dhe Rinas”, sipas urdhër shpenzimi nr.201, datë 22.10.2014, për vlerën 288,000 lekë në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

8.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **135,928 lekë**, nga Gj.P. sa përfituar më tepër në mbikëqyrjen e objektit “Ndërtim i shkollës 12-vjeçare Orenjë” dhe objektit “Ndërtim Ure tip bejl për fshatrat Gurakuq dhe Rinas”.

Brenda muajit Mars 2017

9.Gjetje nga Auditimi: U konstatua **dëm ekonomik** në vlerën **53,700 lekë**, nga likuidimi para mbarimit të kontratës me 7 (shtatë) muaj e 5 ditë, të faturës nr. 20, datë 05.05.2015, për blerjen e vogël “Shërbim interneti për vitin 2015” nga subjektit privat R.R. në ish- Komunën Orenjë në kundërshtim me afatin një vjeçar të kontratës së datës 22.01.2015.

9.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **53,700 lekë** nga N.L. 26,850 lekë dhe F.H. 26,850 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

10.Gjetje nga Auditimi: U konstatua se me urdhër shpenzimin nr.120, datë 03.07.2014, është likuiduar **shuma 20,000 lekë dëm ekonomik**, gjobë në favor të MF, pa dokumentuar arsyet e vendosjes së gjobës, pa nxjerrë përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar ish-Komunës Orenjë.

10.1Rekomandim: Bashkia Librazhd, të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore, për arkëtimin nga ish-Kryetari i Komunës Orenjë z. N.L. të vlerës **20,000 lekë**.

Brenda muajit Mars 2017

11.Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 janë kryer pagesat e bonusit të transportit për ish-Kryetarin e Komunës Hotolisht F.A. në vlerën **60,000 lekë** në kundërshtim me nenin 2, të ligjit nr.169/2013, datë 07.11.2013 “Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit për disa funksionar publikë”.

11.1 Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **60,000 lekë** nga F.A. detyrim për përfitimin e bonusit të transportit.

Brenda muajit Mars 2017

12.Gjetje nga auditimi: U konstatuan shkelje afati të kontratave në 5 raste, në ish-Komunën Hotolisht, për vitin 2014, duke shkaktuar **dëm ekonomik** në vlerën **131,854 lekë**, si më poshtë:

- subjekti “██████████” në vlerën **13,553 lekë**, furnizim dru zjarri;
- subjekti “██████████” në vlerën **15,400 lekë**, pjesë këmbimi;
- subjekti “██████████” në vlerën **102,901 lekë**, pastrim dhe transport i mbetjeve urbane,shërbimi lyerjes me gelqere në shkolla, blerje dru zjarri për nevojat e ish-Komunës Hotolisht, në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 24.1 likujdimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar, pika “a”.

12.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **131,854 lekë** nga subjekti “██████████” për vlerën 13,553 lekë, subjekti “██████████” në vlerën 15,400 lekë, “██████████” në vlerën 102,901 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

13.Gjetje nga auditimi: U konstatua **dëm ekonomik** në vlerën **120,000 lekë**, nga likuidimi i plotë i faturës nr.13 datë 02.12.2013, të operatorit ekonomik “██████████” për blerjen e vogël “Shërbim interneti” në ish-Komunën Hotolisht, përlllogaritur dhe paguar shërbimi për gjithë vitin 2013, kur ky shërbim sapo ishte kontraktuar në datë 02.12.2013, në kundërshtim me VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr.2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr.5 datë 16.07.2013 dhe nr.1, datë 28.02.2014.

13.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **120,000 lekë**, nga subjekti privat R.R.

Brenda muajit Mars 2017

14.Gjetje nga auditimi: U konstatuan 3 raste shpenzimi për blerje mallrash, në ish-ish-Komunën Hotolisht, me procedura prokurimi blerje e vogël, pa bërë hyrje mallrash në magazinë, **për vlerën 1,079,990 lekë dëm ekonomik**, detajuara si më poshtë:

- subjekti “██████████” sh.p.k, në vlerën **887,990 lekë**, për dy raste, blerje materiale të ndryshme për pastrim dhe ngrohje dhe mirëmbajtje, pastrim, blerje çakulli për rrugë dytësore;

- subjekti "██████" sh.p.k, në vlerën **192,000 lekë**, për blerje shtypshkrime, pa dokumentuar hyrjet në magazinë, në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

14.1.Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,079,990 lekë** respektivisht nga subjekti "██████" sh.p.k 887,990 lekë dhe subjekti "██████" sh.p.k 192,000 lekë.

Brenda muajit Mars 2017

15.Gjetje nga auditimi: U konstatua në dy raste shpenzime për blerje mallrash dhe mirëmbajtje e riparime në ish-Komunën Hotolisht, me procedura prokurimi blerje e vogël, likuiduar malli dhe shërbimi para hyrjes në magazinë ose marrjes në dorëzim në vlerën **1,278,570 lekë dëm ekonomik**, si më poshtë:

-subjekti "██████" Durrës, likuiduar fatura nr.640, datë 16.04.2015, me urdhër shpenzimin nr.60, datë 11.05.2015 për vlerën **798,570 lekë**, pasi fletë hyrja e karburantit është në datë 25.05.2015, **39 ditë pas prerjes së faturës dhe 15 ditë pas likuidimit të saj;**

-subjekti "██████" sh.p.k, likuiduar fatura nr.2 datë 11.05.2015, me urdhër shpenzimin nr. 64, datë 12.05.2015, për vlerën **480,000 lekë**, pasi Komisioni i marrjes në dorëzim me 5 vetë, është ngritur në datë 20.5.2015, ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim është hartuar në datë 28.4.2015 (22 ditë më përpara ngritjes së komisionit të marrjes në dorëzim) në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të MF "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36.

15.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 1,278,570 lekë nga ish titullari F.A. dhe komisioni i blerjeve me vlera të vogla G.A. L.Ç. dhe Xh.B. në vlerën 252,975 lekë secili si dhe dhe komisioni i marrjes në dorëzim të punimeve/shërbimeve i përbërë nga A.P. Q.A. M.G. Sh.L. dhe E.Ç. në vlerën 53,333 lekë secili.

Brenda muajit Mars 2017

16. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar, në ish-Komunën Stëblevë janë kryer pagesa për transportin e nxënësve të shkollës në favor të subjektit S.Q. pa aplikuar tatimi mbi të ardhurat në vlerën **63,124 lekë dëm ekonomik**, në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Mbi tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 9, pika 2.

16.1. Rekomandim: Bashkia Librazhd të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **63,124 lekë**, nga subjekti S.Q.

Brenda muajit Mars 2017

17.Gjetje nga auditimi: U konstatua **dëm ekonomik** në shumën **73,000 lekë**, në tenderin me objekt "Blerje kamion për nevoja të ish-Komunës Orenjë", viti 2014, fondi limit 1,250,000 lekë, lloji i procedurës "Kërkesë për propozim", pasi KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik "██████" sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" pika "c", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.

17.1.Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masat administrative dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **73,000 lekë**, nga KVO dhe titullari i autoritetit kontraktor ish-Komuna Orenjë, përkatësisht B.H. 18,250 lekë, G.P. 18,250 lekë, F.H. 18,250 lekë, N.L. 18,250 lekë, për s'kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik "██████" sh.p.k në procedurën e prokurimit "Blerje kamion për nevoja të ish-Ish-Komunës Orenjë", viti 2014.

Brenda muajit Mars 2017

18.Gjetje nga auditimi: Në ish-Ish-Komunën Qendër Librazhd u konstatua **dëm ekonomik** në shumën **439,430 lekë**, në tenderin me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Babje, Komuna Qendër Librazhd", lloji i procedurës "Kërkesë për propozim", viti 2014, fondi limit 5,583,320 lekë, pasi KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik "██████" sh.p.k me ofertë më të ulët, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.1.2007 "Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik” Kreu V Zhvillimi i procedurave”, pika 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, gërma “ç” si dhe nenin 2 “Parimet e përzgjedhjes” pika “c”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

18.1 Rekomandimi: Bashkia Librazhd të marrë masat administrative dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e **vlerës 439,430 lekë**, nga KVO dhe titullari i autoritetit kontraktor ish-Komuna Qendër Librazhd, përkatësisht E.C. 109,857 lekë, Sh.K. 109,857 lekë, I.Gj. 109,857 lekë, E.Sh 109,857 lekë për s’kualifikim të padrejtë të operatorit ekonomik “██████” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Babje, Komuna Qendër Librazhd”, viti 2014.

Brenda muajit Mars 2017

19.Gjetje nga auditimi:Në objektin “**Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave**”, Bashkia Librazhd, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Librazhd **dëm ekonomik në vlerën në 3,788,329 lekë pa tvsh.**

19.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,788,329 lekë** pa tvsh nga OE “██████” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Menjëherë

20. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave**”, Bashkia Librazhd, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 1,207,500 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik, për punime të pakryera në fakt.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. T S , neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

20.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,207,500 lekë** pa tvsh nga OE “██████” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1211, datë 25.08.2014 me objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

21.Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave Faza e II-të**”, Bashkia Librazhd, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit

financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Librazhd **dëm ekonomik në vlerën në 3,464,633 lekë pa tvsh.**

21.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,464,633 lekë pa tvsh** nga OE “” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt “Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave Faza e II-të”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Menjëherë

22.Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i Rrugës Kryesore të Fshatit Dragostunjë, Njësia Administrative Qendër”, Bashkia Librazhd, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 1,713,697 lekë pa tvsh për punime të pakryera.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. R T, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3.

22.1.Rekomandim: Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,713,697 lekë pa tvsh** nga BOE “” shpk dhe “” shpk, në cilësinë e sipërmarrësve në kontratën nr. 1321, datë 31.03.2016, me objekt “Ndërtim, Sistemim, Asfaltim i Rrugës Kryesore të Fshatit Dragostunjë, Njësia Administrative Qendër”, Bashkia Librazhd, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

23.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Librazhd më datën 31.12.2015 nuk janë pasqyruar si debitorë në Pasqyrat Financiare 2015,141 **Biznese dhe HEC-e në vlerën 13,878,022 lekë,** (vlera prej 8,137,785 lekë u përket ish-komunave dhe vlera 5,740,237 lekë u përket HEC-eve me kontratë) nga e cila **12,250,468 lekë** janë detyrime të papaguara, ndërsa **1,627,556 lekë** përfaqëson kamat vonesa për mos pagesa në afat.

Nga auditimi rezulton se për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nga 5-ish Komunat, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Steblevë, Polis dhe Orenjë, nuk janë nxjerrë listat e debitorëve dhe nuk janë dërguar në zyrën e financës, për tu regjistruar si debitorë duke mos hapur analizat (partitarët), **në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:**

a.Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe 7.

b.VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, Kap I, “Mbajtja e kontabilitetit”, pika 2 shkronja (c), “Dokumentet e kontabilitetit”, pika 2.3 “Rregullat e përgjithshme të mbajtjes së librave dhe dokumenteve të tjera të kontabilitetit”

c. ligjin nr.10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4 pika 26, neni 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësve zbatues”

d- Udhëzimi i Ministrit Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve pika 3.

23.1.Rekomandimi: Nga Zyra e taksave të Bashkisë Librazhd të merren masa për regjistrimin në kontabilitet si debitorë, krijimin e regjistrit elektronik, të merren masa për arkëtimin **dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për 141 Biznese dhe HEC-e në vlerën 13,878,022 lekë.**

Bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, **(pavarësisht kërkesave të mëparshme duke i rikërkuar edhe njëherë për 145**

biznesevet debitorë në vlerën 11,818,426 lekë më datën 30.09.2016 në Bashkinë Librazhd të cilat janë regjistruar në kontabilitet dhe ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë".

b. Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit vendosja e barrës siguruese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në R.SH" të ndryshuar.

c. Në rast se subjektet edhe pas dërgimit të urdhër bllokimeve në Bankë dhe njoftimeve zyrtare, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008" ndryshuar me ligjin nr.164/2014, dt.4.12.2014, pasi të vendosen masa administrative gjobë e barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më tepër se 365 ditë kalendarike, të kërkohet kallëzim penal në zbatim të nenit 131 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikat 130-132 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Kodit Penal i R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

d.Nga ana e Zyrës së taksave Bashkia Librazhd të listohen në mënyrë elektronike **abonentët familjarë** dhe të merren masa për arkëtimin e taksave të tokës **nga 4515 fermerë** për vlerën **20,008,981 lekë**, taksa e popullatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të MF nr. 01, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, **të njoftohen** tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor **edhe në median lokale** (të Bashkisë Librazhd dhe 5 njësité Administrative Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Steblevë, Polis dhe Orenjë), për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të Njoftim Vlerësimit me anë të Zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifrat etj,si më poshtë:

Shënim: Gjatë periudhës së auditimit pas konstatimit të mos pagesës së taksave vendore, nga zyra e taksave Bashkisë Librazhd u morën masa të menjëhershme dhe u arkëtuan për periudhën nga data 1.09.2016 deri 15.12.2016 nga 60 biznese dhe 400 fermerë tokash është arkëtuar vlera prej **8,000,000 lekë**.

Taksat për bizneset dhe taksën e tokës në Njësitë administrative dhe Bashkinë Librazhd, për periudhën nga data 01.01.2012 deri 30.09.2016, paraqitet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Nr ANEX I T	Sipas Bilancit Kontabel me dt. 31.12.2015		Sipas Listave analitike						
			Nr	Leke	Gjendje debitorë me dt.30.09.2016		Biznese private			Debitorët e Tokës	
					Numri	Shuma totale detyrimit 30.06.2016	Shuma totale detyrimit Pa regjistru Dëm ekonomik	Kamatvonesë	Numri i aneksit per deb e tokës	Numri	Leke
	Bashkia Librazhd Aneks 1	1	160	12.314.370	145	11.818.426					
A	Shuma A		160	12.314.370	145	11.818.426					
2	Njesia Admin Qender	2			50	6.246.216	4.996.973	1.249.243	2/1	2136	12.833.665
3	Njesia Adm Hotolisht	3			46	1.631.312	1.305.050	326.262	3/1	1169	703.460
4	Njesia Admist , Lunik	4			5	15.625	12.500	3.125	4/1	949	1.630.180
5	Njesia Adm, Stebleve	5			0	0	0	0	5/1	126	1.653.782
6	Njesia Admist, Polis	6			11	231500	185200	46300	6/1	35	944.674
7	Njesia Admis Orenje	7			5	13.132	10.506	2.626	7/1	100	2.243.220
B	Shuma 6 Njësitë Administrative				150	8,137,785		1,627,556		4,515	20.008.981
8	Taksa Lejet Minerare	8			10	1.043.750					
9	Taksat Koncesione	9			7	917,000					
C	Gjithsej Taksat (Leje Minerare + Koncesione)					1,960,475	1,960,475				
D	Zenie Hapesire Publike Koncesion Gjithsejt, nga të cilat:				13	19.864.910					
	Me Kontratë				6	3,779,762	3,779,762				
	Pa Kontratë				7	16,085,148					
	Shuma 2				141	29,046,445		1,627,556		4515	20.008.981

	SHUMA 1+2		160	12.314.370	286	41,781,598	12,250,468	1,627,556		4515	20.008.981

Shenim: Listat analitike Aneksat nr 1- 9 për secilin debitor ndodhen të printuara dhe në formë elektronike pranë Zyrës Taksave Librazhd.

B/2. SHPENZIME NË KUNDËRSHTIM ME PRINCIPET E EFEKTIVITETIT, EFICENCËS DHE EKONOMICITETIT TË FONDEVE PUBLIKE (3-E).

1. Gjetje nga auditimi: Në 5 procedura prokurimi, u evidentuan gjetje në vlerën **20,163,635 lekë** fonde të Bashkisë Librazhd, të përdorura pa **efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet**, të detajuara si më poshtë.

a. Në procedurën e prokurimit me objekt **"Sistemim asfaltim rruge, tregu qytetit, lagje re Ushtaraku dhe Shkumbini në Bashkinë Librazhd"** lloji "Tender i hapur", viti 2015, fondi limit 79,916,408 lekë, u konstatua se, KVO ka skualifikuar operatorin ekonomik BOE "██████" sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" pika "c" dhe nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 tw LPP i ndryshuar, duke bërë që diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues BOE "██████" sh.p.k (78,664,126 lekë) dhe ofertës së skualifikuar BOE "██████" sh.p.k (73,127,540 lekë) në vlerën **5,536,586 lekë, fonde publike të Bashkisë Librazhd, të mos përdoret me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.**

b. Në procedurën e prokurimit me objekt **"Rehabilitimi i qendrës së qytetit dhe lysterjes së fasadave, Faza e II në qytetin e Librazhdit"**, për vitin 2015, lloji "Procedurë e Hapur", fondi limit 58,680,833 lekë, u konstatua se KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik BOE "██████ & ██████" sh.p.k, me ofertën më të ulët, në kundërshtim me nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" pika "c" dhe nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, duke bërë që diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues BOE "██████" sh.p.k (55,728,054 lekë) dhe ofertës së skualifikuar BOE "██████" sh.p.k. (52,400,743 lekë) në vlerën **3,327,311 lekë, fonde publike të Bashkisë Librazhd, të mos përdoret me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.**

c. Në procedurën e prokurimit me objekt **"Rikonstruksion Ujësijesi Qytet Librazhd"**, për vitin 2015, lloji i procedurës "Procedurë e Hapur", fondi limit 127,935,413 lekë, u konstatua se KVO ka skualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik BOE "██████" sh.p.k me ofertën më të ulët, në kundërshtim me nenin 2 "Parimet e përzgjedhjes" pika "c", nenin 46 "Kualifikimi i ofertuesve", pika 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, si dhe për kritere të vendosura në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", pika 7, neni 26 "Kontrata për punë publike" nga Njësia e prokurimit të autoritetit kontraktor, duke bërë që diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues (125,243,502 lekë) dhe ofertës së skualifikuar (118,850,590 lekë), në vlerën **6,392,912 lekë, fonde publike të Bashkisë Librazhd, të mos përdoret me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet.**

d. Në procedurën e prokurimit të llojit **"Procedura me negociim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës"** me objekt "Furnizim me ushqime, fruta për kopshtet, çerdhe e qëndër ditore, për një periudhë 2 mujore të Bashkisë Librazhd", viti 2014, fondi limit 647,284 lekë, rezultoi se nuk janë argumentuar dhe dokumentuar shkaqet e përdorimit të procedurës, duke shmangur procedurat e hapura, shmangur konkurrencën, diskriminuar pjesëmarrjen e kandidatëve të tjerë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu IV "Llojet dhe përzgjedhja e procedurës", pika 5, germa "a". Për sa më lart është lidhur kontratë në vlerën 634,940 lekë me operatorin Z.Q. Si rezultat vlera **634,940**

lekë fonde buxhetore nuk është përdorur me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet në buxhetin e bashkisë Librazhd .

f.Në procedurën e prokurimit me objekt “**Ndërtim sistemim asfaltim i rrugës kryesore të fshatit Dragostunjë, njësia Administrative Qendër**”, viti 2016, fondi limit 137,224,222 lekë, u konstatua se, KVO gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE [REDAKTUAR] sh.p.k, me mangësi në pagesën e taksave vendore, mosplotësim të kriterëve teknike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për taksat vendore” i ndryshuar dhe Dokumentave Standarte të Tenderit (DST), pika 2”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, nënpika 2.3”Kapaciteti teknik”, duke bërë që diferencë midis ofertës së operatorit të shpallur fitues BOE [REDAKTUAR] sh.p.k (134,479,663lekë) dhe ofertës së skualifikuar [REDAKTUAR] sh.p.k (130,207,777 lekë), në vlerën **4,271,886 lekë, fonde publike të Bashkisë Librazhd, të mos përdoret me efektivitet, efizienz dhe ekonomicitet.**

1.1. Rekomandim: Autoriteti kontraktor dhe njësia e prokurimit e Bashkisë Librazhd në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit të parashikojë nevojat për prokurim të mallrave apo shërbimeve, të bëj kujdes në përpunje me kërkesat ligjore zgjedhjen e procedurës së prokurimi, llogaritjen e fondit limit (argumentimin e vlerësimit të kontratës) dhe përcaktimin e specifikimeve teknike të veçanta në DST, që të bëjë të mundur që KVO të bëjë një vlerësim objektiv dhe jo diskriminues për operatorët pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe me leverdi ekonomike për fondet buxhetore duke krijuar kushtet për pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve ekonomik.

C. MASA ADMINISTRATIVE

C.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimeve përcaktuar në nenin 7,të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, dhe pikat 9, 10 dhe 14, të Udhëzimit të KM nr. 3, datë 15.02.2001”Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar,

Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar me ligjin nr.183/2014 datë 01.04.2013”Për ndërtimet e kundërligjshme” Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar dhe nenin 15”Sanksionet”, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” **i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit Mbrojtjes Territorit Vendor të Bashkisë Librazhd që, të vlerësojë shkeljet** e konstatuara, duke vendosur gjoba për 3 personat nga të cilët 1 projektues dhe 2 mbikëqyrës punimesh si më poshtë:

1.Ing. G.Gj. me detyrë me detyrë përfaqësues ligjor i firmës projektuese “[REDAKTUAR]” shpk në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit, të vendosë masë administrative me gjobë në masën **500,000 lekë** për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

a- Në procedurat e hartimit të projekt preventivit për objektin: “**Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave**”, Bashkia Librazhd, janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën 6,297,702 lekë pa tvsh, nga të cilat 3,788,329 lekë pa tvsh (6,297,702 -2,509,373), përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përpunje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit. Diferenca e mësipërme ka ardhur si pasojë vendosjes së çmimeve mbi ato të manualit teknik të çmimeve në fuqi si dhe vendosja në analizë e çmimeve mbi ato të çmimeve të marra nga ofertuesit pas sondazheve të kryera në treg. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve fondi limit është rritur në vlerën **6,297,702 lekë pa tvsh.**

b- Në procedurat e hartimit të projekt preventivit për objektin: “**Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave Faza e II-të**”, Bashkia Librazhd janë preventivuar më tepër

fond limit në vlerën **6,449,612 lekë** pa tvsh, nga të cilat 3,464,633 lekë pa tvsh (6,449,612 - 2,984,979), përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit. Diferenca e mësipërme ka ardhur si pasojë vendosjes së çmimeve mbi ato të manualit teknik të çmimeve në fuqi si dhe vendosja në analizë e çmimeve mbi ato të çmimeve të marra nga ofertuesit pas sondazheve të kryera në treg. Si rrjedhojë e këtyre veprimeve fondi limit është rritur në vlerën **6,449,612 lekë pa tvsh**.

2. Ing.T.S. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 100,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”**, Bashkia Librazhd, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,207,500 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

3. Ing. Th.D. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për**, për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt **“Rehabilitimi i Qendrës së Qytetit dhe Lyerja e Fasadave”**, Bashkia Librazhd, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerën **1,207,500 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt**. Veprime këto në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

II. Për Agjencinë e Prokurimit Publik (APP)

I.Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”*, shkronjën “i” dhe të nenit 13 Agjencia e Prokurimit Publik, nenit 72 Kundërvajtjet administrative, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **8 punonjësve** si më poshtë:

1. Enver Shkurti, N/Kryetar i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e titullarit të ish-Komunës Qendër Librazhd, **për shkelje në tenderin me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Babje, Komuna Qendër Librazhd”** për vitin 2014, për arsye se:

Ka miratuar vlerësimin e bërë nga KVO, për kriteret të papërcaktuara në DST duke s’kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “██████” sh.p.k me ofertë të leverdisëshme ekonomike dhe kualifikimin e operatorin “██████” sh.p.k me ofertën më të lartë dhe shkaktuar dëm ekonomik në buxhetin e ish-Komunës Qendër Librazhd.

2. M.B. ing.hidroteknike, në cilësinë antares së njësisë prokurimit,

3. I.H. Përgjegjës i burimeve njerëzore, në cilësinë anëtarit të njësisë prokurimit dhe në cilësinë e anëtarit të KVO,

4. B.A. ekonomiste, në cilësinë përgjegjëse e njësisë prokurimit dhe në cilësinë e anëtares së KVO,

5. R.H. në cilësinë e anëtarit të KVO

6. A.L. në cilësinë e anëtarit të KVO

7. Sh.K. në cilësinë e anëtarit të KVO

8. S.K. në cilësinë e anëtarit të KVO

për shkeljen e përbashkëta, si më poshtë:

Për tenderat e vitit 2015

1.Në tenderin e zhvilluar në Bashkinë Librazhd, në vitin 2015, me objekt **“Sistemin asfaltim rruge, tregu qytetit, lagje re, ushtaraku dhe Shkumbini në Bashkinë Librazhd”**, me fond limit 79,916,408 lekë, me procedurë prokurimi tender i hapur, të fituar nga BOE ”[REDAKTUAR] & “[REDAKTUAR]” sh.p.k me vlerë 78,664,126 lekë pa tvsh rezultoi se:

- Në kërkesat e veçanta për kualifikim, në kapacitetin teknik, janë aplikuar kriterëve të tilla si Kontrate pune me inxhinier të certifikuar në fushën e sigurimit teknik, mbrojtjen kundra zjarrit, menaxhimin e mbetjeve në kantier si dhe ndihmën e shpejtë kërkesë e tejkaluar mbi VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III.

-Gjithashtu vendosja e kriterit të inxhinierit të pyjeve është i panevojshëm pasi në preventiv shpenzimet për mbjelljen e pemëve dekorative zënë 3% të shumës totale dhe zbatimi i punimeve mund të realizohej nga një teknik pyjesh në kundërshtim me neni 46 të LPP pasi nuk është ”në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe diskriminues

- KVO në këtë procedurë prokurimi ka vepruar me dy standarte pasi ka skualifikuar BOE “[REDAKTUAR]” sh.p.k për mospagim të taksave vendore për Komunën Shushicë ndërkohë që ka vlerësuar dhe shpallur fitues BOE “[REDAKTUAR]” & “[REDAKTUAR]” sh.p.k me taksa vendore të papaguara në Komunën Hotolisht.

-Veprimet e autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd referuar kësaj procedure prokurimi kanë diskriminuar ofertuesit dhe nuk kanë siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike duke i shpenzuar në kundërshtim me principet e efektivitetit, efijencës dhe ekonomicitetit të fondeve publike (3-E), për vlerën **5,536,586 lekë**.

2.Në tenderin e zhvilluar në Bashkinë Librazhd, në vitin 2015, me objekt **”Rehabilitimi i qendrës së qytetit dhe lyerjes së fasadave, Faza e II në qytetin e Librazhdit”**, procedurë e hapur,për vitin 2015, me fond limit 58,680,833lekë, me procedurë prokurimi tender i hapur, të fituar nga BOE “[REDAKTUAR]” sh.p.k me vlerë 55,728,054 lekë pa tvsh, rezultoi se:

-Në DST janë aplikuar kriterëve të tilla si “Kontrate noteriale me specialist (punonjës me arsim të lartë) të certifikuar në fushën e sigurimit teknik, mbrojtjen kundra zjarrit, menaxhimin e mbetjeve në kantier si dhe ndihmën e shpejtë (të dokumentuar me Diplomën e shkollës, certifikatat përkatëse të vlefshme e kontratën e punës)” ku kërkohet që ky specialist të disponojë njëkohësisht gjithë kualifikimet një lloj diskriminimi pasi vendosja e këtij kriteri nuk ka stimuluar pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm me kapacitetete të kufizuara njerëzore dhe nuk është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet dhe diskriminues.

-KVO ka skualifikuar ofertën me leverdi ekonomike dhënë nga operatori BOE ”[REDAKTUAR]” sh.p.k duke mos marrë në konsideratë kapacitetet financiare që zotëron ky bashkim operatorësh, kontratat e punëve të realizuara nga operatori si dëshmi e kapaciteteve të tij për realizimin e kësaj kontrate, por është skualifikuar për mosplotësim të një kushti teknik pa kërkuar sqarime nga operatori “[REDAKTUAR]” sh.p.k në kundërshtim me VKM nr.914,datë 29.12.2014“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 66

Veprimet e autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd referuar kësaj procedure prokurimi kanë diskriminuar ofertuesit dhe nuk kanë siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike duke i shpenzuar në kundërshtim me principet e efektivitetit, efijencës dhe ekonomicitetit të fondeve publike (3-E), për vlerën **3,327,311 lekë**.

3. Në tenderin e zhvilluar në Bashkinë Librazhd, në vitin 2015, me objekt **“Rikonstruksion Ujësjiellësi Qyteti Librazhd”**, procedurë e hapur, të fituar nga BOE “[REDAKTUAR]” sh.p.k me vlerë 125,243,502 lekë pa tvsh, rezultoi se:

-Njësia e prokurimit disa kriterë të veçanta kualifikimi për objektin “Rikonstruksion Ujësjiellësi Qyteti Librazhd”, i ka formuluar në mënyrë evazive dhe jo të qartë, të cilat nuk ndikojnë në qëllimin e realizimin e procedurës së prokurimit, çka ka ndikuar tek KVO në skualifikimin e operatorëve ekonomik, duke mos i dhënë prioritet faktorit ekonomik me vlerë të leverdishme ekonomike.

-KVO ka vepruar me dy standarte pasi për operatorin e skualifikuar BOE ”[REDAKTUAR]” nuk ka marrë parasysh vlerësimin për objektin e ngjashëm të sipërcituar ndërkohë që ka marrë parasysh

vlerësimin për objekt të ngjashëm për operatorin e shpallur fitues BOE "██████" sh.p.k në objektin "Ndërtim i linjave të ujësjellësit për fshatrat Pashtresh, Xibresh, Valesh, Bildese, Srkoze, Bregshemplak, Kafer, Dervish", Komuna Gjinar Elbasan.

-KVO nuk janë marrë parasysh faktin se BOE "██████" sh.p.k, me ofertë më të ulët ekonomike, kishte kapacitete teknike dhe ekonomike për të realizuar në kohë këtë kontratë prokurimi, por ka kualifikuar BOE "██████" me ofertë më të lartë ekonomike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik", pika 7, neni 26 "Kontrata për punë publike"

-Veprimet e autoritetit kontraktor Bashkia Librazhd referuar kësaj procedure prokurimi kanë diskriminuar ofertuesit dhe nuk kanë siguruar mirëpërdorimin e fondeve publike duke bërë që shuma 6,392,912 lekë fonde buxhetore të shpenzohen në kundërshtim me principet e efektivitetit, efijencës dhe ekonomicitetit të fondeve publike (3-E).

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit pjesë e shërbimit civil:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, shkronjat b,c,*"llojet e masave disiplinore"* të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe nenin 64 shkronja g dhe k të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, nga **"Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj"** parashikuar në nenin 58 shkronja (b), **deri në pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet**", parashikuar në nenin 58 shkronja (c), **për 1 punonjës** sa vijon:

1. zj.B.A. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës deri më 15.02.2016, aktualisht Përgjegjëse e Buxhetit për shkeljet e konstatuara:

- në mos planifikimin për vitin 2015 e në vazhdim të fondeve për vendime gjyqësore për 12 ish punonjës në shumën prej 3,854,520 lekë,

-në transferimin e fondit të ndihmës për shpërndarje nga Posta Shqiptare sha dega Librazhd pa kontratë në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1237, datë 16.12.2009, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik " pika 35/germa. A,

-në moskryerjen e rakordimeve të fondit të ndihmës ekonomike me Postën Shqiptare sha dega Librazhd , në mos marrjen e masave në kthimin në kohë të fondit të NE të pa tërhequr nga individë në shumën prej 230 240 lekë nga dega e Postës sha Librazhd,

- për mos argumentim të përdorimit të procedurës "Me negociim pa botim paraprak të njoftimit kontratës" në cilësinë e anëtares së njësisë prokurimit, në tenderin me objekt "Furnizim me ushqime, fruta për kopshtet, çerdhe e qendër ditore, për një periudhë 2 mujore", viti 2014,

D.2. Për punonjësit të cilët marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës

-Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 " Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar " dhe kontratën individuale të punës , neni 64, shkronjat g dhe k të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i rekomandojmë **Kryetarit të Bashkisë Librazhd, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, "vërejtje" deri në zgjidhje të kontratës së punës" për 12 punonjësit e mëposhtëm:**

1. E.SH. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër Librazhd deri 30.06.2015 dhe aktualisht nën Kryetar i Bashkisë Librazhd, për mos zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në ish-Komunën Qendër Librazhd për 4 masa me efekt financiar në vlerën 17,837,395 lekë, dhe mos zbatimin e 11 masave për shpërbllim dëmi, për 55 subjekte dhe persona në vlerën 2,218,654 lekë.

- Për pagesat e 30 ish këshilltarëve të Komunës Qendër në vlerën **2,508,854 lekë** për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, veprim në kundërshtim me nenin 29, pika 2, të ligjit nr. 8652, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe nenin 31 pika 2.

-Për pagesat e kryera për shpenzime lindjeje në 20 raste në vlerën **100,000 lekë** të pa argumentuara dhe me dokumentacion justifikues të pavlefshëm, certifikatë për efekt dokumenti apo dublikatë, të cilat përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik veprim në kundërshtim me nenin 27 pika 1 dhe nenin 42 pika 2 të ligjit nr.10129, datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”.

- Për pagesën e këshilltarit S.A. për periudhën Dhjetor 2013 dhe Janar- Shkurt 2014 pa aplikuar tatimin mbi të ardhurat në vlerën **2,355 lekë**, veprim që përbën shkelje të kërkesave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

- Për mos aplikim sanksioni në vlerën **4,995 lekë** ndaj subjektit S.C. për blerje materiale pastrimi, për 7 ditë vonesa në dorëzimin e mallit.

2. A.F. me detyrë ish Kryetar i Komunës Steblevë deri më 30.06.2015 aktualisht Administrator i Njesisë Administrative Steblevë Librazhd,

- Për vitet 2013, 2014 dhe 2015 nuk janë zbatuar detyrat e lëna nga auditi i mëparshëm për masat e shpërblimit të demit nga 6 subjekte dhe persona në vlerën **1,259,587 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe germa b neni 11 dhe pika 4 neni 18 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me ligjin nr.10318, datë 16.09.2010 i ndryshuar.

- Për përfitimin e bonusit të transportit është përfituar padrejtësisht për periudhën Nëntor– Dhjetor 2013,në vlerën **30,000 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr.169/2013, datë 07.11.2013 “Për përfitimin financiar mujor të shërbimit të transportit për disa funksionar publik”.

- Për pagesat e telefonisë celulare në vlerën **196,000 lekë**, veprim në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik e publik”.

- Për pagesat e kryera për transportin e nxënësve të shkollës në favor të subjektit S.Q. për të cilin nuk është aplikuar tatimi mbi të ardhurat në vlerën **63,124 lekë**, veprim që përbën shkelje të kërkesave të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

- Për mos aplikim sanksioni për 24 ditë vonesa në dorëzimin e mallit në vlerën **8,371 lekë** ndaj subjektit I.Gj. për blerje goma automjeti për nevojat e Komunës.

-Në cilësinë e ish kryetari i Komunës aktualisht nga muaji korrik 2015 Administratori Njesisë administrative Steblevë.

-Pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre, nuk kanë marrë masat e nevojshme ligjore për grumbullimin e taksave duke krijuar një të ardhur të munguar në buxhetin e njësisë vendore për mos pagimin e taksës së tokës nga 126 fermerë në vlerën **1,653,782 lekë**.

3. J.K. me detyrë administratore e ndihmës ekonomike në Njësinë Qendër, për mosveprim sipas detyrave funksionale në zbatim të nenit 5 të ligjit nr. 10399, datë 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9355, datë 10.03.2005“ Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar në lidhje me shkeljet e konstatuara në administrimin e fondit të shpërndarë të ndihmës ekonomike për 13 persona në shumën 112,260 lekë për periudhën Janar-Qershor të vitit 2016.

4. B.K. me detyrë ish ing në Zyrën e Urbanistikës Njësia Polis deri më 15.02.2016, aktualisht inspektor i IMT, për shkeljet e konstatuara gjatë vitit 2015, për procedurën blerje e vogël “Për shpenzime mirëmbajtje rrugësh“, në 4 rrugë të ish Ish-Komunës në vlerë prej 202,800 lekë u konstatua se nuk është dokumentuar me projekt dhe planimetri, sasia e punimeve të përcaktuara tek preventivi në 4, veprime në kundërshtim me nenin 40 të VKM nr.914, datë 24.12.2014 “ Për rregullat e prokurimit publik”.

Nga puna e pamjaftueshme në mos grumbullimin e taksave vendore për vitet 2013,2014 deri në muajin Korrik 2015, nuk kanë regjistruar si debitorë, në kontabilitet dhe nuk kanë marrë masa për arkëtimin nga subjektet e biznesit detyrimet tatimore vendore (taksa +tarifat) duke krijuar

një të **ardhur të munguar për buxhetet** e ish Komunave respektive, në vlerën **6,246,216 lekë**, nga e cila taksat dhe tarifa e papaguar në vlerën **4,996,973 lekë** dhe kamatëvonesa në vlerën **1,249,243 lekë** dhe mos vjeljen e taksës tokës nga 2136 fermerë në vlerën **12,833,665 lekë**.

5. Sh.Z. ish-Përgjegjëse e zyrës financës, aktualisht inspektore taksave në Bashkinë Librazhd. Pasi me veprimet apo mos veprimet e saj, nuk kanë marrë masat e nevojshme ligjore për grumbullimin e taksave duke krijuar një të ardhur të munguar në buxhetin e njësisë vendore në vlerën **1,645,805 lekë**, nga të cilat për 5 biznese debitore në vlerën 15,625 lekë dhe 949 fermerë për mos pagimin e taksës së tokës në vlerën 1,630,782 lekë.

6. C.D. përgjegjës i zyrës Tatim Taksave.

Pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre, nuk kanë marrë masat e nevojshme ligjore për grumbullimin e taksave duke krijuar një të ardhur të munguar në buxhetin e njësisë vendore për mos pagimin e taksës së tokës nga 126 fermerë në vlerën **1,653,782 lekë**.

7. B.Zh. administrator i Njesisë Administrative Polis.

8. K.H. inspektori i taksave.

Pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre, nuk kanë marrë masat e nevojshme ligjore për grumbullimin e taksave duke krijuar një të ardhur të munguar në buxhetin e njësisë vendore në vlerën **1,176,174 lekë**, nga të cilat për 11 biznese debitore në vlerën 231,500 lekë dhe 35 fermerë për mos pagimin e taksës së tokës në vlerën 944,674 lekë.

9.B.D. Administratori i Njesisë Administrative Orenje.

10.H.Gj. Specialisti i taksave.

Pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre, nuk kanë marrë masat e nevojshme ligjore për grumbullimin e taksave duke krijuar një të ardhur të munguar në buxhetin e njësisë vendore në vlerën **2,356,362 lekë**, nga të cilat për 5 biznese debitore në vlerën 10,506 lekë dhe 100 fermerë për mos pagimin e taksës së tokës në vlerën 2,256,362 lekë.

11. B.Ç. me detyrë administrator i Njesisë Administrative Hotolisht.

12. E.Ç. specialiste e taksave nga muaji Korrik 2015 dhe në vazhdim.

Pasi me veprimet apo mos veprimet e tyre dhe nga puna e pamjaftueshme në mos grumbullimin e taksave vendore për vitet 2012-2013-2014 nga 34 subjekte me pasojë shkaktimin e **një dëm ekonomik në buxhetin e ish-Komunës** Hotolisht në vlerën 1.631,133 lekë, nga e cila taksë e papaguar vlere 1.305,050 lekë dhe kamatëvonesa vlere 325,263 lekë, mbajnë përgjegjësi personat e mëposhtëm:

Auditimi i kryer në ish-Komunat Steblevë, Polis, Orenjë, Lunik, Hotolisht dhe Qendër Librazhd , vlerësohet dobët nga Kryetari i KLSH-së dhe do të riauditohet në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor dhe Drejtoria Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R